

INFORMACION ORIENTUES

PËR SHTETASIT E HUAJ

VIKTIMA TË TRAFIKIMIT OSE VIKTIMA TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

Informimi mbi procedurat e punësimit, të drejtat në punë, adresa të strukturave që mbrojnë të drejtat e e/imigrantëve. Imigrim i mirëinformuar për motive punësimi në Republikën e Shqipërisë

❖ Informacion i përgjithshëm

Hyrja dhe qëndrimin për punësimin i të huajve në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr.79/2021 “Për të huajt” dhe aktet nënligjore të tij.

Për të punuar në Republikën e Shqipërisë, shtetasi i huaj duhet të pajiset me leje unike. Përjashtim përbëjnë rastet kur përcaktohet ndryshe në ligj, marrëveshje ndërkombëtare apo me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Leja unike është dokumenti i lëshuar nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, që lejon shtetasin e huaj të qëndrojë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime pune.

Lejet kryesore që lidhen me punësimin janë: leje unike si punëmarrës, leje unike për punësim stinor, leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes, leje unike si punëtor ndërkufitar, leje unike për formim profesional, leje unike për sportistë, leje unike për shërbim vullnetar, leje unike për punonjës me kualifikim të lartë, leje unike për persona të vetëpunësuar, leje unike për punonjës lëvizës digjital, leje unike për investitorë, leje unike për shërbime kontraktuese dhe leje unike për kategori të veçanta.

Legjislacioni shqiptar ndalon punën e detyruar në të gjitha format e saj, njeh ndalimin e diskriminimit dhe zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion.

Informacioni i mëposhtëm ka në fokus punësimin e shtetasve të huaj në **kategorinë e punëmarrësve**, duke qenë se është dhe kategoria me numrin më të madh të lejeve unike.

❖ Je shtetas i huaj? Cfarë duhet të bësh për të punuar si punëmarrës në Republikën e Shqipërisë?

Për të punuar si punëmarrës në Republikën e Shqipërisë, shtetasi i huaj duhet të pajiset me leje unike.

❖ Kush aplikon për leje unike?

Aplikimi për lejen unike bëhet nga vetë i huaji ose nga punëdhënësi i tij.

❖ **Ku bëhet aplikimi për leje unike?**

Kërkesat për leje unike për motive pune, bëhen në portalin qeveritar e-albania¹, në seksionin “Kërkesë për leje unike / Unique permit”, shërbimi elektronik "Aplikim për Leje Unike".

Në momentin e përfundimit të aplikimit të huajt ose punëdhënësit të tij, i dërgohet një njoftim në adresën elektronike, për kryerjen me sukses të aplikimit, duke gjeneruar edhe një numër gjurmimi.

Autoriteti për marrjen e aplikimit dhe lëshimin e lejes unike është *autoriteti i kufirit dhe migracionit*.

Për kategoritë e të huajve, të cilat në bazë të ligjit duhet të marrin miratimin e punësimit, aplikimi shqyrtohet dhe aprovohet on-line fillimisht nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin për punësim nga marrja e kërkesës për miratim për punësim, kur janë plotësuar të gjitha kriteret e tjera ligjore ose nga momenti i plotësimit të tyre.

Miratimi për punësim mund të jetë i kufizuar në kohë, llojin e punësimit, punësim, rajon specifik dhe shpërndarje të orëve të

punës. Këto kufizime duhet të vendosen në lejen unike ose të qëndrimit.

Në disa raste, kur punëdhënësi që ofron vendin e punës nuk ka zhvilluar një aktivitet të rregullt dhe ka shkelur legjislacionin rregullues për ushtrimin e aktivitetit të tij, si dhe legjislacionin e punës, dhe në rastet kur shtetasi i huaj dhe vetë punëdhënësi paraqesin informacione të rreme, miratimi për punësim mund të refuzohet.

❖ **Cfarë dokumentacioni nevojitet për të aplikuar për leje unike si punëmarrës?**

Për t’u pajisur me leje qëndrimi, i huaji depoziton on-line këto dokumente:

- Formularin e aplikimit për lëshimin e lejes së qëndrimit përkatësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi, i cili gjendet on-line pa pagesë, fotografi të aplikuesit, të bëra jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.
- Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe

¹ https://e-albania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/15388/DPPSH_15388_n4_s1_web.aspx?service_code=15388

fotokopjen e faqeve me shënime me interes për udhëtimin, si dhe gjenealogjet e mbajtësit, viza e tipit “D”, vulat në hyrje-dalje.

- Vetëdeklarim për akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, i cili përmbush kushtet higjieno – sanitare.
- Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar reciprocitet në thjeshtimin e dokumentacionit për përfitimin e lejes së qëndrimit, zbatohen përcaktimet në marrëveshje.
- Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë (ku përcaktohet periudha e punësimit, pozicioni i punës, profesioni, paga dhe elementë të tjerë) në gjuhën shqipe.
- Dëshmi aftësimi profesional (diplom/certifikatë profesionale/referenca) ose vetëdeklarim nga i huaji në format jetëshkrimi (CV), që vërteton aftësitë/eksperiencën e mëparshme profesionale të të huajit, në lidhje me profesionin e përcaktuar në kontratën e punës në gjuhën shqipe.

❖ **Sa kohë zgjat shqyrtimi i aplikimit?**

Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhen brenda një afati maksimal prej 12 javësh nga dita e aplikimit.

Miratimi apo refuzimi i kërkesës i njoftohet në adresën e e-mailit të deklaruar gjatë aplikimit.

❖ **A mund të ndryshojë motivi i lejes unike, punëdhënësi, kontrata e punës apo adresa e qëndrimit?**

I huaji që është pajisur me një leje unike nga autoritetet shqiptare, ka detyrimin t’i përmbahet motivit të lëshimit të lejes unike. Ai mund të ndryshojë punëdhënësin ose adresën e tij apo kontratën e punës, por fillimisht duhet të njoftojë autoritetet dhe marrë miratim për këtë ndryshim.

Mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi periodik i procedurave të lëshimit të lejeve të qëndrimit bëhen nga struktura përgjegjëse për të huajt në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Një punëdhënë në Republikën e Shqipërisë nuk mund të punësojë një shtetas të huaj që qëndron në mënyrë të parregullt në vend.

❖ **A mund të ankohej në rast refuzimi të lëshimit të lejes unike?**

- Kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes ose të anulimit të lejes unike, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
- Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror

bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative sipas legjislacionit në fuqi.

❖ **A mund të ankojem në rast se jam tashmë i punësuar dhe më shkelen të drejtat në punë?**

Në rast se jeni tashmë në një marrëdhënie pune dhe ndodhëni përballë shkeljeve si më poshtë:

1. Ndihehi i diskriminuar
2. Po punoni pa një kontratë individuale pune
3. Po shtrëngoheni të punoni në kushte të caktuara dhe të papërshtatshme për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
4. Punëdhënësi po ju kërcënon se do t'ju dorëzojë te autoritetet nëse nuk pranoni kushtet e punës
5. Nuk keni akses në pagesë
6. Punëdhënësi nuk ju informon mbi pagën dhe elementët e saj
7. Kostot e jetesës ju zbriten nga paga
8. Punoni me orare të stërzgjatura
9. Flini aty ku punoni
10. Punëdhënësi nguron t'ju vërë në dispozicion dokumenta
11. Nuk keni ditë pushimi
12. Nuk keni akses në shërbimin shëndetësor
13. Po punoni i pa siguruar
14. Jeni të ekspozuar ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale

Drejtohuni pranë **Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**.

❖ **A mund të punosh në rast se ke leje qëndrimi si viktimë trafikimi/viktimë e mundshme trafikimi?**

Në rast se je shtetas i huaj, viktimë e trafikimit/viktimë e mundshme trafikimi në Republikën e Shqipërisë, mund të pajisesh me leje qëndrimi si viktimë trafikimi/viktimë e mundshme trafikimi. Kjo leje është me afat 1 – vjeçar dhe të jep mundësinë e qëndrimit dhe të punësimit në Republikën e Shqipërisë. Punëdhënësi nuk ka detyrimin të marrë më parë miratim nga AKPA, por vetëm të njoftojë lidhjen e marrëdhënies së punës.

❖ **Baza ligjore**

- ✓ Ligji 79/2021, “Për të huajt”.
- ✓ VKM Nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji Nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

❖ **Adresa të nevojshme dhe adresa të strukturave që mbrojnë të drejtat e e/imigrantëve**

- **E – albania:**

Aplikim për leje unike

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15146

- **Regjistrim si punëkërkuar i papunë.** Nëse je shtetas i huaj me qëndrim të rregullt në RSH i regjistruar në zyrën e gjendjes civile dhe je i interesuar për t'u regjistruar si punëkërkuar i papunë mund të ndjekësh linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12544
- **Regjistrim në kurs formimi profesional.** Nëse je shtetas i huaj me qëndrim të rregullt në RSH i regjistruar në zyrën e gjendjes civile dhe je i interesuar për ndjekjen e një kursi formimi ndiq linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12549.
- **Regjistrim në programet e nxitjes së punësimit.** Nëse je shtetas i huaj me qëndrim të rregullt në RSH i regjistruar në zyrën e gjendjes civile me statusin viktimë trafikimi/ viktimë e mundshme trafikimi mund të bëhesh pjesë e programeve të nxitjes së punësimit: “Programi i punësimit”, “Programi i formimit nëpërmjet punës”, “Programi i praktikave profesionale” dhe “Programi i Punëve Publike në Komunitet”.

- **Policia e Shtetit** (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, autoriteti përgjegjës për lëshimin e lejes unike):

E-mail: <https://asp.gov.al/kontakt/>; Tel: 112 ku mund të kërkohej ndihmë për çdo emergjencë.

- **Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive** (autoriteti përgjegjës për dhënien e miratimit për punësim)

<https://www.puna.gov.al/rrethnesh/kontakt>

Tel: +355 44 52 83 63; Punëdhënësi: tel: +355 44 52 83 63; Punëkërkuar: tel: +355 44 52 83 63

- **Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore** (autoriteti përgjegjës për garantimin e kushteve të punës dhe sigurisë në punë)

E-mail: info@sl.gov.al;

web: <https://inspektoriatipunes.gov.al/>; Tel: +355042368466

- **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

08000606, numri jeshil pa pagesë; E-mail ne adresen:

<https://www.kmd.al/kontakt/>

<https://www.kmd.al/si-mund-te-ankoheni/>

- **Ndihma Juridike Falas** (VT/VTM janë kategori që përfitojnë ndihmë juridike falas)

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/kategorite-qe-perfitojne/> ; Kontakti dhe E-mail ne adresen:

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/faq/> ; Tel: 0800 10 10 Numri i Gjellbër (Pa Pagesë).